



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republik of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



R R E G U L L O R E

PËR
PROCEDURËN E THEMELIMIT, PËRBËRJEN DHE KOMPETENCAT E
KOMITETEVE TË PËRHERSHME NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Prishtinë, 2014

Në pajtim me dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 51, paragrafi 51.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 16, paragrafi 3 të Udhëzimit administrative të MAPL-së nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika c dhe të dispozitave të nenit 44, paragrafi 44.1 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 1.12.2014, miratoi

R R E G U L L O R E N
P Ë R
PROCEDURËN E THEMELIT, PËRBËRJEN DHE KOMPETENCAT E
KOMITETEVE TË PËRHERSHME NË KOMUNËN E PRISHTINËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Qëllimi

Neni 1.

Qëllimi i hartimit të kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës së themelimit, përbërjes - numrit të anëtarëve, kompetencave dhe përgjegjësive të komiteteve të përhershme të Komunës së Prishtinës.

2. Përkufizimi

Neni 2

Komitetet janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, të cilat punojnë për Kuvendin dhe në emër të Kuvendit. Roli i tyre është që ta lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve, pasi që Kuvendi nuk është në gjendje që, në tërësi dhe në mënyrë adekuate, të merret me numrin e madh të çështjeve që mund të parashtrihen në Komunë.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

3. Themelimi i komiteteve të përhershme

Neni 3

1. Kuvendi i Komunës merr vendim për themelimin dhe përbërjen e komiteteve të përhershme.
2. Kuvendi i Komunës themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, si komitete të përhershme.

3. Komitetet njoftohen rregullisht për propozimvendimet dhe raportet tjera periodike, për aktivitetet e drejtorive përkatëse dhe të ndërmarrjeve publike lokale, që përgatiten për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi.

4. Kryesuesi i komitetit është përgjegjës për koordinimin e punës së komitetit dhe përgatit orarin e mbledhjeve, udhëheq listën e pjesëmarrësve, siguron procedurat e kompensimit të anëtarëve të komitetit, jep informata mbi vlerësimin individual të kryerjes së punëve nga anëtarët dhe i paraqet raport Kuvendit për punën e komitetit.

5. Komitetet e kanë të drejtën e bashkëpunimit me organet e Administratës, institucionet arsimore dhe shëndetësore, ndërmarrjet publike lokale të Komunës, si dhe ministrinë relevante.

6. Drejtorja e Administratës ofron mbështetje të nevojshme logjistike dhe administrative për sigurimin e kushteve të nevojshme për mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve, duke përfshirë: shpërndarjen e materialeve për mbledhje, vendtakimet, procesmbajtësin, vendosjen e procesverbaleve në dosje dhe të materialeve të tjera të komiteteve.

4. Komitetet e përhershme

1. Komiteti për Politikë dhe Financa

1.1.Përbërja

Neni 4.

1. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga përfaqësuesit e subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvendin e Komunës.

2. Komitetin për Politikë dhe Financa e përbejnë njëmbëdhjetë (11) anëtarë, të cilët reflektojnë përfaqësimin e entiteteve politike si dhe numrin e ulëseve nga entitetet politike të përfaqësuara në Komunë.

3. Komitetin për Politikë dhe Financa e kryeson kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Në mungesë të tij, mbledhja kryesohet nga anëtari më i vjetër nga mosha.

1.2 Kompetencat

Neni 5.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për:

1. Shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik;

2. Kornizën vjetore buxhetore afatmesme;

3. Planin vjetor të prokurimit;

4. Rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat;

5. Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm;

6. Buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal;

7. Marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës;
8. Shqyrtimin dhe rekomandimin e programeve investuese dhe të shpenzimeve të buxhetit;
9. Shqyrtimin dhe vendosjen për ndihmat e menjëhershme në raste urgjente, të cilat i kalojnë autorizimet e Kryetarit të Komunës dhe për këtë e njofton Kuvendin;
10. Dhënien e mbështetjes për zhvillimin ekonomik brenda Komunës, duke përfshirë strukturimin ekonomik;
11. Këshillimin e Kuvendit, në mënyrë të përgjithshme, në lidhje me zbatimin e procedurave financiare dhe ekonomike;
12. Ushtrimin e të gjitha funksioneve të Kuvendit të Komunës në raste emergjente, të cilat përcaktohen nga Kryetari i Komunës, përpos atyre që nuk delegohen;
13. Propozimin e shlyerjeve të borxheve;
14. Komiteti, për secilën periudhë tremujore, i përcjell Kuvendit të Komunës raport mbi gjendjen financiare të Komunës.

2. Komiteti për Komunitete

2.1 Përbërja

Neni 6.

1. Komiteti për Komunitete përbëhet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve.
2. Komiteti për Komunitete përfshin anëtarët e komuniteteve jo shumicë, të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës dhe jashtë tij.
3. Komiteti për Komunitete përbëhet nga nëntë (9) anëtarë:
 - **një (1) nga komuniteti rom**, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - **një (1) nga komuniteti turk**, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - **një (1) nga komuniteti ashkali**, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - **një (1) nga komuniteti boshnjak**, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
 - **dy (2) nga komuniteti serb**, njëri duhet të jetë anëtar i Kuvendit;
 - **tre (3) nga përfaqësuesit e shumicës, shqiptarë**, së paku njëri prej tyre duhet të mos jetë anëtarë i Kuvendit të Komunës.
4. Anëtarët e Komitetit për Komunitete nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe jashtë tij, emërohen nga Kuvendi i Komunës.

2.2. Zgjedhja e anëtarëve në Komitetin për Komunitete.

Neni 7.

1. Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit për Komunitete bëhet me propozimin e kandidatëve të ofruar nga komuniteti jo shumicë, ndërsa miratimi bëhet nga Kuvendi i Komunës.
2. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më vjetër nga mosha i komitetit.
3. Komiteti për Komunitete përfaqësohet edhe nga një anëtar i komuniteteve jo shumicë, të cilët nuk janë të përfaqësuar në Kuvend.

3. Kompetencat

Neni 8.

Komiteti për Komunitete është përgjegjës për:

1. Shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim, dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve, për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht;
2. T'i rekomanduar Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve, për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor;
3. Të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës dhe
4. Ushtron edhe përgjegjësi të tjera, nëse nuk është rregulluar ndryshe me LVL- në dhe me Statutin e Komunës.

5. Mbledhjet e komiteteve të përhershme

Neni 9.

1. Mbledhjet thirren nga kryesuesi i komitetit, por edhe me kërkesë të 1/3 së anëtarëve të komitetit të përhershëm.
2. Komitetet e përhershme mbajnë mbledhje të rregullta dhe urgjente, varësisht nga nevoja.
3. Ftesa për mbledhjet e rregullta të komiteteve të përhershme, përmban:
 - 3.1 rendin e ditës,
 - 3.2 kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes,
 - 3.3 materialet e mbledhjes, në gjuhë zyrtare dhe në gjuhë në përdorim zyrtar në Komunë.
4. Ftesa për mbledhje duhet t'u dërgohet anëtarëve shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

5. Mbledhjet urgjente thirren nga kryesuesi dhe me kërkesën e 1/3 së anëtarëve, për çështje konkrete që duhen trajtuar me urgjencë.
6. Për secilën mbledhje, komiteti mban procesverbal, i cili miratohet nga komiteti në mbledhjen e radhës.

6. Rekomandimet dhe raportimi në komitetet e përhershme

Neni 10.

1. Rekomandimet e komiteteve të përhershme merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
2. Komitetet e përhershme e dorëzojnë raportin vjetor për punën e tyre pranë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

7. Mandati i anëtarëve të komiteteve të përhershme.

Neni 11.

1. Mandati i anëtarëve të komiteteve të përhershme është 4-vjeçar dhe ai përfund me përfundimin e mandatit të Kuvendit të Komunës.
2. Mandati i anëtarit të komitetit të përhershëm pushon:
 - 2.1 me rastin e përfundimit të mandatit të tij,
 - 2.2 me dorëheqjen e anëtarit,
 - 2.3 në rast të vdekjes,
 - 2.4 nëse nuk merr pjesë tri herë radhazi në mbledhje,
 - 2.5 kur anëtari kalon në ndonjë entitet tjetër politik, zëvendësohet me anëtarin tjetër të të njëjtit subjekt politik të cilit i ka takuar anëtari me rastin e zgjedhjes.

8. Përgjegjës për zbatim

Neni 12.

Kuvendi i Komunës dhe komitetet e përhershme, janë përgjegjëse për zbatimin e kësaj rregulloreje.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13.

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushojnë të vlejnë dispozitat e nenit 1, pikat **a** dhe **b**, dhe të neneve 3, 4 dhe 5 të Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve, 01. nr. 110 -1200, dt. 16.06.2010.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 110-273423, më 09.12.2014.

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.